




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 22/20
Datë: 20.12.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 dhjetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Përafrimin e Kornizës Ligjore Vendore për Sanksionet Ndërkombëtare me qëllim të harmonizimit me Standardet Ndërkombëtare (Plotësim/Ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare).
2. Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Ramush HARADINAJ
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

KONCEPT DOKUMENTI
PËR PËRAFRIMIN E KORNIZËS LIGJORE VENDORE PËR SANKSIONET
NDËRKOMBËTARE ME QËLLIM TË HARMONIZIMIT ME STANDARDET
NDËRKOMBËTARE

1. Hyrje

1.1. Zbatimi i sanksioneve ndërkombëtare në Republikën e Kosovës mund të konsiderohet si fushë relativisht e re, pasi që Ligji për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare për herë të parë është miratuar në vitin 2010. Fusha e zbatimit të sanksioneve ndërkombëtare në Republikën e Kosovës është rregulluar me Ligjin Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, i shpallur me dekretin Nr. DL-018-2010, datë 04.05.2010 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më 03/06/2010 (këtu e tutje Ligji për ZSN).

1.2. Në përgjigje të rritjes dhe përhapjes së sulmeve terroriste në mbarë botën, komuniteti ndërkombëtar është bashkuar në fushatën për të ngrirë fondet ose pasuritë e tjera të terroristëve dhe atyre që financojnë terrorizmin apo organizatat terroriste. Në kuadrin e kësaj fushate, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara ka miratuar rezolutat 1267 (1999) dhe 1373 (2001) ndërkohë që detyrimet ndërkombëtare në këtë fushë, janë pasqyruar gjithashtu në Rekomandimin ndërkombëtar të Task Forcës për Veprim Financiar (TFVF) e cila në vitin 2012 ka rishikuar standardet ndërkombëtare mbi Luftën kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit e Terrorizmit, konkretisht rekomandimi 6 i cili përcakton sanksionet specifike financiare të lidhura me terrorizmin dhe financimin e terrorizmit, ndërsa rekomandimi 7 i TFVF-së ka të bëjë me sanksionet specifike financiare të lidhura me përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë.

1.3. Ashtu si Kombet e Bashkuara edhe Komuniteti Evropian e kishte njohur nevojën e luftës kundër financimit të terrorizmit, mirëpo pas 11 shtatorit 2001, procesi i luftës së terrorizmit ndërkombëtar nga ana e Bashkimit Evropian u intensifikua dhe u përshpejtua mbi bazën e Rezolutës 1373/2001. Në këtë kontekst u miratuan; Rregullorja nr. 2580/2001 mbi masat kufizuese specifike, kundër disa personave dhe enteve të caktuara; Rregullorja 881/2001 e cila vinte detyrime specifike dhe kufizime në lidhje me persona dhe grupe që kishin lidhje me Osama Bin Laden, rrjetin e Al-Qaida dhe Talibanët, e cila shfuqizoi Rregulloren CE nr.467/200, dhe forcoi dhe zgjeroi më tepër ngrirjen e kapitaleve dhe të të ardhurave të tjera financiare në lidhje me Talibanet e Afganistanit.

1.4. Në Kosovë bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, Qeveria e Republikës së Kosovës me datë 17/09/2014 ka marrë një vendim¹ për të vendos sanksione ndaj pasurisë së individëve, entiteteve dhe autoriteteve të cilat kanë shkelur sovranitetin e Ukrainës duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe institucioneve të Bashkimit Evropian të datës 16 Korrik 2014, i cili vendim i përket më tepër natyrës ekomomike. Ky njehërit ka qenë edhe vendimi i vetëm i nxjerrë bazuar në Ligjin për ZSN, mirëpo që pas marrjes së këtij vendim nga institucionet e zbatimit të ligjit janë identifikuar disa mangësi të ligjit në fuqi e të cilat kanë të bëjnë me sanksionet specifike financiare të lidhura me terrorizmin dhe financimin e terrorizmit dhe sanksionet specifike financiare të lidhura me përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë.

¹ Vendim Nr. 09/196 i datës 17/09/2014 i cili ka të bëjë me vendosjen e sanksioneve ndaj pasurisë së entiteteve juridike, autoriteteve dhe individëve që kanë shkelur sovranitetin e Ukrainës.

1.5. Marrë parasysh, në njëërën anë, kërcënimet ndaj terrorizmit dhe financimit të tij dhe faktin që kjo fushë viteve të fundit ka pësuar ndryshime të konsiderueshme në kuadër të standardeve ndërkombëtare dhe, në anën tjetër, identifikimin e mangësive të ligjit në fuqi për ZNS, ka lindur nevoja e trajtimit të kësaj fushe me këtë Koncept Dokument.

1.6. Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2015-2018 përbëhet nga pesë shtyllat kryesore, shtylla të cilat janë përcaktuara si prioritet për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe të cilat janë si në vijim:

- 1.6.1. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, punësimi dhe mirëqenia;
- 1.6.2. Sundimi i ligjit dhe shteti ligjor;
- 1.6.3. Agjenda evropiane dhe politika e jashtme;
- 1.6.4. Arsimi, shkenca, kultura, sporti dhe zhvillimi rinor; dhe
- 1.6.5. Shëndetësia moderne

1.7. Arritja e këtyre qëllimeve qeveritare në përgjithësi, e veçanërisht shtyllës së dytë që ka të bëjë me sundimin e ligjit i jep rëndësi dhe prioritet të veçantë edhe luftës kundër terrorizmit me ç'rast Qeveria e Republikës së Kosovës zotohet që në një afat kohor shumë të shpejtë do të miratojë legjislacionin përkatës si dhe do të hartojë politika të qëndrueshme për të parandaluar dhe për të luftuar terrorizmin. Për më tej, Republika e Kosovës aspiron të bëhet pjesë përbërëse e strukturave rajonale dhe globale të sigurisë, në veçanti e NATO-së, BE-së, OSBE-së dhe OKB-së, si dhe do të përkushtohet që të ngritët bashkëpunimi me të gjitha vendet për të luftuar terrorizmin.

1.8. Po ashtu, lidhur me luftën kundër terrorizmit në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2016 në pikën 5.3.6 specifikohet se kornizës ligjore në Kosovë për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive i mungojnë dispozita të veçanta mbi financimin e terrorizmit dhe këto asete janë konfiskuar si çdo aset tjetër kriminal sipas rregullave të përgjithshme të konfiskimit. Andaj, nuk ka mekanizëm për sekuestrimin dhe konfiskimin e fondeve apo pasurive të tjera që lidhen me terrorizmin në bazë të rezolutave përkatëse të OKB-së.

1.9. Qeveria e Republikës së Kosovës me qëllim të përmbushjes së obligimeve dhe zotimeve që ndërlihen me parandalimin dhe luftimin e terrorizmit dhe financimit të terrorizmit ka hartuar disa ligje dhe dokumente strategjike të cilat janë si në vijim:

- Ligji Nr. 05/L -002 për Ndalimin e Bashkimit në Konflike të Armatosura Jashtë Territorit të Vendit, i shpallur me dekretin Nr. DL-003-2015, datë 25.03.2015;
- Ligjin Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit i shpallur me dekretin Nr. DL-015-2016, datë 13.06.2016;
- Strategjia Kombëtare Kundër Terrorizmit 2012-2017;
- Strategjia për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Informale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terorizmit dhe Krimeve Financiare për vitin 2014-2018;
- Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që Shpie në Terrorizëm 2015-2020;

përmes të cilave synohet që Kosova të jetë pjesë e koalicionit global në luftën kundër terrorizmit.

1.10. Gjithashtu, në planin vjetor të punës së Qeverisë nga MPJ për vitin 2017 në kuadër të aktivitetit 7.6 është paraparë hartimi i koncept-dokumentit mbi ndryshimet dhe plotësimet eventuale të Ligjit për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, i cili veprim ndërlidhet me objektivin 2.4 "Rritja e efikasitetit të mekanizmave të zbatimit të ligjit në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, krimin të organizuar dhe luftimin e terrorizmit". Po ashtu në Strategjinë për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Informale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare për vitin 2014-2018, ku në kuadër të objektivit 2.6 "Zhvillimi i legjislacionit kombëtar në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe sigurimi i zbatimit të tij efikas" është paraparë aktiviteti 2.6.2 që ka të bëjë me sigurimin e zbatimit efektiv të sanksioneve ndërkombëtare që në shënjestër kanë terrorizmin dhe financimin e terrorizmit, si dhe përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë përmes rishikimit të Ligjit për Zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare, duke siguruar ngrirjen e fondeve dhe të pasurive siç kërkohet me sanksione ndërkombëtare dhe duke e sanksionuar dështimin për t'iu bindur sanksioneve ndërkombëtare në Kodin Penal.

1.11. Andaj, qëllimi dhe objektivat e propozimit të këtij Koncept Dokumenti janë në pajtim me obligimet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, përfshirë Marrëveshjen e Asocim Stabilizimit (MSA) të nënshkruar në mes të Kosovës dhe BE-së dhe interesit tonë shtetëror për integritet euroatlantike, Programit Qeveritar 2015-2018, Planit Vjetor të Punës së Qeverisë për Vitin 2017, Ligjit për Ndalimin e Bashkimit në Konflikte të Armatosura Jashtë Territorit të Vendit, Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, Strategjisë Kombëtare Kundër Terrorizmit, Strategjisë për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Informale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare dhe Strategjisë për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që Shpie në Terrorizëm, si dhe do të kontribuojnë në realizimin e obligimeve që burojnë nga këto dokumente.

2. Përshkrimi dhe definimi i çështjeve kryesore

2.1. Kërcënimet ndaj paqes dhe sigurisë ndërkombëtare të shkaktuara nga aktet terroriste vitet e fundit kanë ndikuar në miratimin e rezolutave specifike nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara siç janë Rezoluta 1373, por edhe rezolutat e tjera të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara që kanë dalë në zbatim të Rezolutës 1267, por edhe në ndryshimin e standardeve ndërkombëtare në këtë fushë siç janë Standardet e Task Forcës për Veprim Financiar mbi Luftën kundër Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit.

2.2. Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1267 është miratuar në tetor të vitit 1999, në vazhden e rezolutave të mëparshme që kishin të bënin me gjëndjen në Afganistan. Rezoluta gjithashtu vë theksin në shqetësimin për rritjen e shkeljes së të drejtave të njeriut, prodhimit të lëndëve narkotike, përdorimit të territorit të kontrolluar nga Talibanët për trajnimin e terroristëve dhe kryerjen e akteve terroriste në nivel ndërkombëtar. Në funksion të zbatimit të kësaj rezolute është krijuar Komiteti 1267, i cili merr në konsideratë kërkesat që paraqiten nga vendet anëtare për listimin e personave të lidhur me terrorizmit apo financimin e tij, ankesat në lidhje me listimin apo bllokimin e fondeve dhe pasurive të tjera të personave të

shpallur, si dhe raportet e vendeve anëtare në drejtim të zbatimit të saj. Kërkesa kryesore për vendet anëtare në kontekstin e kësaj rezolute ka qenë ngrirja pa vonesë e fondeve dhe pasurive të tjera të Talibanëve, përfshirë këtu dhe të ardhurat e siguruar nga pasuri në pronësinë e tyre direkte apo indirekte si dhe ndërmarrja e masa kundër atyre që shkelin këtë kërkesë.

Më 17 qershor 2011, Këshilli i Sigurimit miratoi unanimisht rezolutat 1988 (2011) dhe 1989 (2011). Me miratimin e këtyre rezolutave, Këshilli i Sigurimit vendosi që lista e personave dhe subjekteve që i nënshtrohen masave të ndahet në dyshe . Komiteti ishte i njohur si Komiteti i Sanksioneve ndaj Al-Kaidës, i mandatuar për të mbikëqyrur zbatimin e masave kundër individëve dhe subjekteve të lidhura me Al-Kaidën. Një komitet i veçantë u krijua në bazë të rezolutës 1988 (2011) për të mbikëqyrur zbatimin e masave kundër individëve dhe subjekteve të lidhur me talebanët që përbëjnë një kërcënim për paqen, stabilitetin dhe sigurinë e Afganistanit.

Më 17 dhjetor 2015, Këshilli i Sigurimit miratoi rezolutën 2253 (2015). Me miratimin e kësaj rezolute, Këshilli i Sigurimit ka vendosur të zgjerojë kriteret e listimit dhe të përfshijë individët dhe subjektet që mbështesin Shtetit Islamik në Irak (ISIS).

2.3. Rezoluta 1373 është miratuar në shtator 2001 dhe disa nga detyrimet kryesore që ajo parashikon për vendet anëtare janë:

- Të parandalojnë dhe ndëshkojnë financimin e akteve terroriste;
- Të dënojnë sigurimin ose mbledhjen e fondeve nga shtetasit e tyre apo në territorin e tyre për kryerjen e akteve terroriste;
- Të sigurojnë ngrirjen pa vonesë të fondeve dhe pasurive të tjera financiare të personave që kryejnë ose sigurojnë mbështetje në kryerjen e akteve terroriste;
- Rezoluta 1373 (2001) gjithashtu ju ndalon të gjithë personave fizikë dhe juridikë të një vendi, të japin çfarëdolloj shërbimesh financiare apo ndonjë formë tjetër mbështetje për personat e shpallur;
- Të parandalojnë nëpërmjet kontrolleve efektive të kufirit, lëvizjen e terroristëve ose grupeve terroriste;
- Të përshpejtojnë dhe intensifikojnë shkëmbimin e informacionit për çështjet e financimit të terrorizmit;

Në zbatim të kësaj rezolute, kërkohet që vendet gjithashtu t'i japin njëri tjetrit ndihmesën e duhur në lidhje me hetimet e krimeve ose të procedimeve penale, që lidhen me financimin ose mbështetjen e akteve terroriste;

2.4. Përsa i përket luftës kundër financimit të terrorizmit dhe duke u nisur edhe nga urgjenca për tu kundërpërgjigjur akteve terroriste, efikasiteti i Rezolutave 1267(1999) por edhe rezolutat e tjera që kanë dalë në zbatim të Rezolutës 1267, si dhe Rezolutës 1373(2001) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara u konkretizua me marrjen e veprimeve konkrete dhe masave të nevojshme të cilat patën sukses të menjëhershëm në legjislacionet kombëtare të shteteve të ndryshme mbarë botën.

2.5. Sipas standareteve ndërkombtare të Task Forcës për Veprim Financiar (TFVF) mbi Luftën kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, konkretisht rekomandimi 6 përcakton

sanksionet specifike financiare të lidhura me terrorizmin dhe financimin e terrorizmit, me ç'rast vendet duhet të zbatojnë sanksione financiare specifike, në përputhje me rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, që lidhen me parandalimin dhe goditjen e terrorizmit dhe financimit të tij. Rezolutat u kërkojnë vendeve që të ngrijnë pa vonesë fondet apo pasuritë e tjera dhe të sigurohen se fondet apo pasuritë e tjera nuk vihen në dispozicion, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekte, drejt ose në përfitim të, çdo personi ose subjekti qoftë

(i) i përcaktuar nga, ose nën autoritetin e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara nën Kapitullin VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë në përputhje me rezolutën 1267 (1999) dhe rezolutat pasardhëse të saj, ose

(ii) i shpallur nga ai vend në përputhje me Rezolutën 1373 (2001).

2.6. Ndërsa rekomandimi 7 i TFVF-së ka të bëjë me sanksionet specifike financiare të lidhura me përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë. Sipas këtij rekomandimi vendet duhet të zbatojnë sanksione specifike financiare në përputhje me Rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në lidhje me parandalimin, goditjen, shtypjen dhe pengimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe financimin e tyre. Këto rezoluta u kërkojnë vendeve të ngrijnë pa vonesë fondet apo pasuritë e tjera dhe të sigurohen se nuk ka fonde apo pasuri të tjera në dispozicion, drejtpërdrejt ose indirekt, drejt ose në përfitim të, çdo personi ose subjekti të shpallur nga, ose nën autoritetin e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara bazuar në Kapitullin VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

2.7. Andaj, me qëllim të adresimit të problemeve me të cilat ballafaqohen institucionet e zbatimit të Ligjit të cilat janë vërejtur pas vendimit të Qeverisë Nr. 09/196 i datës 17/09/2014, përfshirë këtu problemet përmbajtjesore dhe ato teknike të Ligjit për ZSN, të cilat janë sqaruar në vijim të këtij koncept dokument, si dhe të sfidave që lindin për harmonizimin e mëtejme të këtij Ligji me standardet ndërkombëtare, Ministria e Punëve të Jashtme ka themeluar Grupin Punues për hartimin e këtij Koncept Dokumentit.

2.8. Gjatë punës së Grupit Punues janë konsideruar të gjitha ligjet dhe dokumentet e paraqitura si në vijim të cilat nga aspekte të ndryshme janë të ndërlidhura me çështjen e cila trajtohet përmes këtij koncept dokumenti, por që asnjë nga këto nuk e mbulon problematikën e identifikuar të këtij koncept dokumenti.

- Kodi Penal i Republikës së Kosovës trajton veprat penale dhe sanksionet penale ku parashihet edhe terrorizmi dhe veprat e tjera të ndërlidhura me terrorizmin;
- Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës përcakton rregullat e procedurës penale të cilat janë të detyrueshme për punën e gjykatave, prokurorisë së shtetit si dhe të pjesëmarrësve të tjerë në procedurën penale. Ky kod rregullon edhe ngrirjen e aseteve, por vetëm pasi që hetimi është i autorizuar për veprën penale sipas nenit 90 të këtij kodi, ndërsa në situatën e trjatur me këtë koncept dokument ngrirja duhet të bëhet me automatizëm për faktin që personi është i listuar në listën e sanksioneve të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.
- Ligji Nr. 05/L -002 për Ndalimin e Bashkimit në Konfliktet të Armatosura Jashtë Territorit të Vendit, i cili përcakton veprën penale të bashkimit apo pjesëmarrjes në ushtrinë ose policinë e huaj, në formacionet e jashtme paraushtarake ose parapolicore,

- në organizimet grupore apo individualisht, në çfarëdo forme të konflikteve të armatosura jashtë territorit të Republikës së Kosovës.
- Ligjin Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, i cili përcakton masat, autoritetet kompetente dhe procedurat për zbulimin, parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit si dhe ka për qëllim implementimin e Direktivës së BE-së 2015/849 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 maj 2015 për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, përcakton ngrirjen e përkohshme të transaksioneve për pastrim parash dhe financim të terrorizmit por vetëm për qëllime të inteligjencës dhe për një periudhë të limituar.
 - Ligji Nr. 05/L-049 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar i cili përcakton funksionet dhe përgjegjësitë e Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, por është i limituar vetëm në procedurën për pasurinë e cila është sekuestruar dhe konfiskuar sipas kodit të procedurë penale.
 - Ligji Nr. 04/L-140 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë së Përfituruar me Vepër Penale, i cili ligj përcakton kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar nga personat që kanë kryer vepër penale, kur procedurat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale nuk janë të mjaftueshme, por por nuk e trajton këtë çështje.
 - Strategjia Kombëtare Kundër Terrorizmit 2012-2017, e cila ka për qëllim edhe fuqizimin e mekanizmave institucional të dedikuar për parandalim dhe luftim të terrorizmit, ngritjen e bashkëpunimit dhe koordinimit institucional në nivel vendi por edhe ngritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar.
 - Strategjia për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Informale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare për vitin 2014-2018 qëllimi i së cilës ka të bëjë me krijimin e një mekanizmi të menaxhimit të rrezikut për rreziqet e nivelit kombëtar të ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare në Kosovë me qëllim të mbështetjes së arritjes së objektivave të Programit të Qeverisë, parasheh si aktivitet në pikën 2.6.2 sigurimin e zbatimit efektiv të sanksioneve ndërkombëtare që në shënjestër kanë terrorizmin dhe financimin e terrorizmit, si dhe përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë përmes rishikimit të Ligjit për Zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare.
 - Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që Shpie në Terrorizëm 2015-2020 synon që të adresojnë faktorët shtytës dhe tërheqës që ndikojnë në radikalizimin e popullsisë, në veçanti të rinjve, përmes arritjes së katër objektivave strategjike: Identifikimi i hershëm i shkaqeve, faktorëve dhe grupeve të targetuara; Parandalimi i ekstremizmit dhe radikalizimit të dhunshëm; Intervenimi me qëllim të parandalimit të rrezikut nga radikalizmi i dhunshëm; De-radikalizimi dhe riintegrimi i personave të radikalizuar si dhe objektivat specifike/masat në kuadër të tyre që Qeveria e Republikës së Kosovës ka me qëllim që të parandaloj dhe zvogëloj rrezikun nga radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm.

2.9. Ligjet dhe dokumentet e lartcekura nuk kanë ndonjë konflikt me çështjen e cila pritet të adresohet përmes këtij koncept dokumenti, pasi që mekanizmi i ngrirjes pa vonesë të fondet apo pasuritë e tjera të personave të listuar si të ndërlidhur me terrorizmin dhe grupet terroriste siç përcaktohet me rezolutat e Këshilli të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1267 dhe rezolutat pasardhëse, si dhe Rezolutës 1373, nuk është e adresuar në këto ligje apo dokumente.

2.10. Grupi punues për hartimin e Koncept Dokumentit kryesisht është fokusuar në realizimin e qëllimit të këtij koncept dokumenti, përmes identifikimit të nevojës së përmbushjes së standardeve ndërkombëtare për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare me legjislacionin përkatës vendor, dhe në identifikimin e problemeve përmbajtjesore dhe teknike të Ligjit për ZSN të cilat mund të vështirësojnë zbatimin.

2.11. **Në aspektin e përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare**, është konstatuar se Ligji është në masën më të madhe në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare siç janë Rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (RKSKB) dhe ato të Bashkimit Evropian, mirëpo janë identifikuar disa mangësitë të caktuara në këtë drejtim, e veçanërisht ato përkitazi me sanksionet financiare që lidhen me terrorizmin, financimin e terrorizmit dhe përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, që duhet të adresohen lidhur me ngrirjen e fondeve apo pasurive të tjera dhe pezullimin e masave të ngrirjes të personave të shpallur nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara siç përcaktohet me rezoluta përkatëse.

2.12. **Në aspektin përmbajtësor**, është konstatuar se Ligji përmban disa probleme pasi që mungon një autoritet kompetent ose gjykata që është në gjendje të përcaktojë në mënyrë të menjëhershme nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme, ose një bazë e arsyeshme për të dyshuar apo të besuar se një person apo entitet është një terrorist, organizatë terroriste apo person që ka lidhje me terroristët; fondet ose pasuritë e tjera që lidhen me terrorizmin t'i nënshtrohen menjëherë procesit të ngrirjes pas konstatimit se ekzistojnë baza të tilla të arsyeshme; dhe ngrirja e fondeve dhe pasurive të tjera kryhet pa njoftimin paraprak të palëve të përfshira;

2.13. **Në aspektin strukturor dhe sistematik**, Ligji ka një strukturë të mirë por disa nene duhet shtuar, disa duhet elaboruar në gjerësisht dhe disa duhet ndryshuar me qëllim që arrihet sistemimi i duhur i dispozitave ligjore duke përfshirë ndryshimet e nevojshme ligjore me qëllim të lehtësimit të zbatimit të tij.

2.14. Sipas dokumentit teknik për Opinion Ligjor mbi rishikimin e Ligjit Nr. 03/L-196 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit në Kosovë të përgatitur nga ekspertë të Këshillit të Evropës² në kuadër të Projektit PECK "Projekti kundër Krimit Ekonomik" të financuara nga Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian, **regjimi i Kosovës për zbatimin e Rekomandimit 6³ të TFVF-së të vitit 2012 dhe Rezolutave përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (RKSOKB) që kërkojnë nga vendet që të ngrijnë pa vonesë pasuritë terroriste dhe të ndalojnë që fondet dhe burimet e tjera (përfshirë shërbimet financiare) t'u vihen në dispozicion personave dhe subjekteve të caktuara është jo i plotë dhe jo gjithmonë në pajtim me standardet**. Ligji Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare (Ligji për ZNS) vendos bazën për zbatimin e "*sanksioneve ndërkombëtare*", të përkufizuara si "*kufizimet dhe detyrimet e caktuara me rezoluta, konventa, marrëveshje, deklarata apo çfarëdo akti të Organizatës së Kombeve të Bashkuara apo ndonjë organizate tjetër ndërkombëtare*" të natyrës ekonomike, financiare, politike, të komunikimit dhe publike (paragrafi (1.2) i nenit 2). Ndonëse nuk ka ndonjë referencë të veçantë për "*ngrirjen*" ose "*ndalimin e ofrimit të fondeve ose pasurive të tjera në dobi të personave ose subjekteve të caktuara*"⁴, këto

² Giuseppe Lombardo dhe Herbert Zammit LaFerla ECCU-PECK-eng-3/2015

³ Rekomandimi i Veçantë III i mëparshëm tani rekomandimi 6 i TFVF-së.

⁴ Fjalorth i Rekomandimeve të TFVF-së, përkufizimi i "sanksioneve të shënjestruara financiare".

mund të përfshihen nga përkufizimi i "Sanksioneve Financiare" (paragrafi (1.4) i nenit 2 të Ligji për ZSN): "kufizimet e të drejtave të subjekteve, ndaj të cilave zbatohen sanksionet ndërkombëtare, për të menaxhuar, përdorur apo disponuar paratë e gatshme, letrat me vlerë, mallrat, pasuri të tjera dhe të drejta pronësore; kufizimet e pagesave për subjektet kundër të cilave zbatohen sanksione ndërkombëtare; kufizime të tjera mbi aktivitetet financiare". Sidoqoftë, sipas këtij Opinion Ligjor, ekzistojnë disa probleme me Ligjin për ZSN, ndër të tjera:

- Ligji për ZSN mbështetet në një vendim të Qeverisë për zbatimin e tij, i cili nuk është nxjerr;
- Atij i mungon një mekanizëm për të identifikuar personat dhe subjektet target për listim në bazë të kritereve të përcaktimit të përcaktuara në rezolutat e Kombeve të Bashkuara të Këshillit të Sigurimit (UNSCR - 1267/2001 dhe rezolutat e saj pasardhëse) dhe për të bërë kërkesë për listime të personave dhe subjekteve tek komiteti kompetent për sanksione në kuadër të OKB-së;
- Ajo nuk ofron një mekanizëm për të identifikuar personat dhe subjektet target për listim, bazuar në kriteret e përcaktimit të përcaktuara në Rezolutën 1373/2001, si dhe për përcaktimin e tyre në pajtim me këtë Rezolutë.
- Ai nuk parashikon autoritet apo mekanizme dhe procedura për të shqyrtuar dhe dhënë fuqi veprimeve të filluara sipas mekanizmave të ngrirjes të vendeve të tjera pajtim me Rezolutën 1373;
- Nuk është e qartë se "sanksionet financiare" do të mbulojë të gjitha rastet e parashikuara nga TFVF.

2.15. Në mungesë të këtyre dispozitave ligjore në kuadër të Ligjit për ZSN institucionet e zbatimit të Ligjit nuk kanë në dispozicion mekanizmin e ngrirjes pa vonesë të fondet apo pasuritë e tjera siç përcaktohet me rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, të cilat janë kërkesa që duhet trajtuar në mënyrë të ndryshme nga mënyra konvencionale e cila është e përcaktuar me Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale.

2.16. Andaj, duke pasur parasysh që mënyra e ngrirjes pa vonesë e fondeve apo pasurive tjera siç përcaktohet me rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara nuk është e përcaktuar me Ligjin për ZSN, kjo paraqat vështësi në zbatimin e tij.

2.17. Disa nga praktikat më të mira që vendet përdorin në këtë proces janë:

2.17.1. Ekzistimi i një autoriteti kompetent ose një gjykate e cila autorizohet për të ngrirë fondet ose pasuritë e tjera, të bazuara në informata mbi të cilat krijohen baza të arsyeshme, për të besuar se këto fonde ose pasuri të tjera janë të lidhura me terroristët. Për këtë qëllim vendet mund të miratojnë procedura ekzekutive, administrative ose gjyqësore, me kusht që:

- një autoritet kompetent ose gjykata është në gjendje të përcaktojë në mënyrë të menjëhershme nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme, ose një bazë e arsyeshme për të dyshuar apo të besuar se një person apo entitet është një terrorist, organizatë terroriste apo person që ka lidhje me terroristët;
- fondet ose pasuritë e tjera që lidhen me terrorizmin i nënshtrohen menjëherë procesit të ngrirjes pas konstatimit se ekzistojnë baza të tilla të arsyeshme;

- ngrirja e fondeve dhe pasurive të tjera kryhet pa njoftimin paraprak të palëve të përfshira;

Këto procedura mund të plotësojnë mekanizma ligjor ekzistues për sekuestrimin dhe konfiskimin civil ose penal.

2.17.2. Përcaktimin e procedurave efektive për të lehtësuar komunikimin, bashkëpunimin dhe bashkërendimin ndërmjet agjencive përkatëse shtetërore dhe subjekteve, gjatë procesit të shpalljes në mënyrë që të:

- të sigurojë të gjitha informatat në dispozicion për të identifikuar me saktësi personin e shpallur (p.sh. data e lindjes, adresa, shtetësia ose numrin e pasaportës të individëve; vende, data dhe vendi i krijimit të shoqërisë, për personat juridik); dhe
- të shqyrtojë dhe bashkërendojë, sipas rastit, çdo shpallje në përputhje me alternativat dhe veprimet që mund të ndërmerren kundrejt terroristëve, organizatave terroriste dhe personat e lidhur me ta.

2.17.3. Projektimin e një procesi për institucionet financiare për të informuar organet kompetente ose gjykatat në lidhje me fondet apo pasuritë e ngrira (emrat, llogaritë, shumatat).

2.18. Institucionet e zbatimit të ligjit dhe institucionet tjera kanë kompetencat në fushat e tyre të përcaktuara, ndërsa përmes ndryshimeve të Ligjit për ZNS do të mund të fuqizohen edhe më tej në zbatimin e kompetencave të cilat mund të përcaktohen në Ligjin për ZNS. Andaj, përvojat e vendeve tjera mund të na shërbejnë në përcaktimin e mekanizmit dhe procesit të ngrirjes dhe de-blokimit të fondeve dhe pasurive tjera siç përcaktohet me Rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

3. Synimet dhe objektivat

3.1. Qëllimi i këtij koncept dokumenti është përafrimin i mëtejshëm i kornizës ligjore vendore për sanksionet ndërkombëtare me qëllim të harmonizimit me standardet ndërkombëtare, në veçanti sanksioneve të përcaktuara në rezolutat e Kombeve të Bashkuara të Këshillit të Sigurimit (UNSCR-1267/2001 dhe rezolutat e saj pasardhëse) dhe në Rezolutën 1373/2001, qëllim i cili synohet të realizohet përmes tri objektivave:

- 3.1. Sistematizimi i duhur i dispozitave ligjore në fuqi;
- 3.2. Harmonizimi i mëtejshëm i legjislacionit me standardet ndërkombëtare; dhe
- 3.3. Evitimi i pengesave në zbatimin e legjislacionit.

4. Opsionet

4.1. Gjatë hartimit të koncept dokumentit janë shqyrtuar tri opsione me të cilat mund të adresohet objektivi i këtij Koncept Dokumenti, e i cili është përafrimi i mëtejshëm i kornizës ligjore vendore për sanksionet ndërkombëtare me qëllim të harmonizimit me standardet ndërkombëtare, të cilat janë paraqitur si në vijim:

4.1.1. Opsioni i adresimit të problemeve me anë të ndryshimit të qasjes së zbatimit dhe ruajtjes së status quos;

4.1.2. Opsioni i adresimit të problemeve me hartimin e akteve nënligjore;

4.1.3. Opsioni i plotësimit dhe ndryshimit të Ligjit ekzistues apo hartimit të Ligjit të ri.

4.2. Gjatë shqyrtimit të opsionit të parë, adresimit të problemeve me anë të ndryshimit të qasjes së zbatimit dhe ruajtjes së status quos, Grupi Punues është dakorduar që ky opsion nuk mund të adresojnë problemet e identifikuar lidhur me zbatimin e ligjit për ZSN dhe harmonizimin e mëtejshëm të tij me standardet ndërkombëtare. Ligjit në fuqi për ZNS i mungon një mekanizëm për të identifikuar personat dhe subjektet target për listim në bazë të kriterëve të përcaktimit të përcaktuara në rezolutat e Kombeve të Bashkuara të Këshillit të Sigurimit (UNSCR - 1267/2001 dhe rezolutat e saj pasardhëse), i mungon një autoritet kompetent ose gjykata që është në gjendje të përcaktojë në mënyrë të menjëhershme nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme, ose një bazë e arsyeshme për të dyshuar apo të besuar se një person apo entitet është një terrorist, organizatë terroriste apo person që ka lidhje me terroristët; i mungon mekanizmi që fondet ose pasuritë e tjera që lidhen me terrorizmin t'i nënshtrohen menjëherë procesit të ngrirjes pas konstatimit se ekzistojnë baza të tilla të arsyeshme për ngrirje, i mungon procedura e ndërmarrjes së veprimeve dhe e drejta e ankesës ndaj vendimeve të marra sipas ligjit për ZNS. Andaj, përafrimi i mëtejshëm i kornizës ligjore vendore për sanksionet ndërkombëtare me qëllim të harmonizimit me standardet ndërkombëtare, nuk mund të bëhet thjeshtë duke ndryshuar qasjen sa i përket zbatimit të Ligjit aktual.

4.3. Sipas opsionit të dytë, adresimit të problemeve me hartimin e akteve nënligjore, Grupi Punues është dakorduar se kjo mënyrë vetëm pjesërisht mund të rregulojë problematikën e identifikuar të ngrirjes së fondeve apo pasurive tjera jashtë mënyrës së rregullimit konvencional, pasi që mangësitë e identifikuar në Ligjin për ZNS nuk mund të rregullohen me akte nënligjore sepse kjo bie ndesh me parimin e ligjshmërisë.

4.4. Andaj, opsioni i vetëm për Grupin Punues dhe opsioni i rekomanduar për Qeverinë e Republikës së Kosovës mbetet opsioni i hartimit të Projektligjit për plotësimit dhe ndryshimit të Ligjit ekzistues apo hartimit të Ligjit të ri (Projektligji), varfërisht nga përmbajtja e ndryshimeve.

4.5. Grupi punues rekomandon elementet kryesore të politikës së propozuar që duhet të trajtohen me Projektligj dhe të cilat do të përqendrohen në aspektin përmbajtësor dhe në atë teknik.

4.6. Disa nga ndryshimet përmbajtësore të kërkuara, por duke mos u limituar, janë si në vijim:

1. Krijimi i një mekanizëm për të identifikuar personat dhe subjektet target për listim në bazë të kriterëve të përcaktimit të përcaktuara në rezolutat e Kombeve të Bashkuara të Këshillit të Sigurimit (UNSCR - 1267/2001 dhe rezolutat e saj pasardhëse) dhe për të bërë kërkesë për listime të personave dhe subjekteve tek komiteti kompetent për sanksione në kuadër të OKB-së; Korrigjimi i menjëhershëm i kësaj mangësie duhet të bëhet duke hartuar një vendim bazuar në

nenin 5 të Ligjit për ZNS i cili menjëherë duhet të ishte në fuqi deri sa ndryshimet e kërkuara të hyjnë në fuqi;

4.7. Krijimin e një mekanizëm për të identifikuar personat dhe subjektet target për listim, bazuar në kriteret e përcaktimit të përcaktuara në Rezolutën 1373/2001, si dhe për përcaktimin e tyre në pajtim me këtë Rezolutë.

4.8. Përcaktimin e autoritetve apo mekanizmave dhe procedura për të shqyrtuar dhe dhënë fuqi veprimeve të filluara sipas mekanizmave të ngrirjes të vendeve të tjera pajtim me Rezolutën 1373 dhe masat që duhet të merren me bllokimet e përkohshme, me sekuestrimet administrative që u bëhen aseteve, deblokimet, procedurat e ndërmarrjes së këtyre veprimeve dhe të drejtat e ankesës ndaj këtyre vendimeve.

4.9. Sqarimin e sanksionet financiare që do të mbulojë të gjitha rastet e parashikuara nga rekomndimet e TFVF-së.

5. Përmbledhja e opsioneve

5.1. Legjislacioni përkatës në fushën e zbatimit të sanksioneve ndërkombtare në Republikën e Kosovës duhet të jetë në përputhje me standardet ndërkombtare dhe evropiane dhe të mundësoj zbatimin e Rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, ashtu siç janë të përcaktuara.

5.2. Edhe pse në masë të madhe Ligji për ZSN është në pajtim, ky ligj nuk është në linjë të plotë me standardet ndërkombëtare dhe Rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Kjo ka më së shumti të bëjë me mungesën e një mekanizëm për të identifikuar personat dhe subjektet target për listim në bazë të kriterëve të përcaktimit të përcaktuara në rezolutat e Kombeve të Bashkuara të Këshillit të Sigurimit (UNSCR-1267/2001 dhe rezolutat e saj pasardhëse) dhe për të bërë kërkes për listime të personave dhe subjekteve tek komiteti kompetent për sanksione në kuadër të OKB-së, gjithashtu nuk ofron një mekanizëm për të identifikuar personat dhe subjektet target për listim, bazuar në kriteret e përcaktimit të përcaktuara në Rezolutën 1373/2001, si dhe për përcaktimin e tyre në pajtim me këtë Rezolutë dhe nuk parashikon autoritet apo mekanizmave dhe procedura për të shqyrtuar dhe dhënë fuqi veprimeve të filluara sipas mekanizmave të ngrirjes të vendeve të tjera pajtim me Rezolutën 1373;

5.3. Në anën tjetër, edhe pse Ligji është në pjesën dërmuese të tij në pajtim me standardet ndërkombtare, institucioni kompetent për administrimin e zbatimit të sanksioneve ndërkombtare dhe institucionet të cilat mbikqyrin zbatimin e sanksioneve ndërkombtare e konsiderojnë Ligjin për ZNS të vështirë për t'u aplikuar pasi që ky ligj nuk ofron mekanizmat e duhur dhe mënyrën e adresimit të problemit të identifikuar që ka të bëjë me ngrirjen pa vonesë të fondeve dhe pasurive të tjera financiare të personave që kryejnë ose sigurojnë mbështetje në kryerjen e akteve terroriste të listuar në listat e krijuara dhe mirëmbajtura nga Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, kohëzgjatjen e ngrirjes dhe deblokimit të ngrirjes së fondeve dhe pasurive dhe delistimi i personave, procesi i trajtimit të ankesave nga palët e prekura nga këto vendime. Andaj, për të trajtuar të gjitha këto është e nevojshme plotësim ndryshimi dhe sistematizimi i Ligjit për ZNS.

5.4. Ndryshimet janë gjithashtu të domosdoshme për të siguruar që Republika e Kosovës të vazhdojë përpjekjet e saj që të bëhet pjesë përbërëse e strukturave rajonale dhe globale të sigurisë, në veçanti e OKB-së, si dhe në përkushtimin e saj që të ngritet bashkëpunimi me të gjitha vendet për të luftuar terrorizmin.

5.5. Ndryshimet do të adresojnë strukturën e Ligjit me objektiv të adresimit të mangësive të Ligjit për ZNS dhe aplikimit më të lehtë. Ndryshimet e tilla përfshijnë përpilimin e dispozitave të përgjithshme kur kjo është e mundur, dhe dispozitat e veçanta vetëm kur dispozitat e përgjithshme nuk janë të mjaftueshme. Ndryshimet gjithashtu do të sqarojnë dispozita të caktuara të ligjit në fuqi për ZNS dhe do të shtohen dispozita për të përmbushur standardet ndërkombëtare në këtë fushë. Përfundimisht, ndryshimet në Ligjin për ZSN gjithashtu do të sqarojnë më tej aplikimin e tij.

6. Analiza e opsioneve

6.1. Sipas opsionit të parë, ndryshimit të qasjes së zbatimit dhe ruajtjes së status quos, Grupi Punues është dakorduar që ky opsion nuk mund të adresojnë problemet e identifikuar lidhur me zbatimin e ligjit për ZSN dhe harmonizimin e mëtejshëm të tij me standardet ndërkombëtare, por mund të ndihmojë në ngritjen e disa kapaciteteve për të cilat kompetencat ligjore tanimë eksiztojnë në ligjin për ZNS.

6.2. Sipas opsionit të dytë, adresimit të problemeve me hartimin e akteve nënligjore, Grupi Punues është dakorduar se kjo mënyrë vetëm pjesërisht mund të rregulojë disa problematika të identifikuar, mirëpo problematika e ngrirja e fondeve apo pasurive tjera jashtë mënyrës së rregullimit konvencional nuk mund të rregullohet me akte nënligjore pasi që bie ndesh me parimin e ligjshmërisë.

6.3. Ndërsa opsioni i tretë, hartimi i projektligjit për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare mbetet opsioni i rekomanduar nga Grupi Punues i cili mund të adresojë në tërësinë e tij problematikën e identifikuar në këtë koncept dokument.

7. Vlerësimi i ndikimit financiar për secilin opsion

7.1. Opsioni i ndryshimit të qasjes së zbatimit dhe ruajtjes së status quos, shqyrtuara nga Grupi Punues nuk rekomandohet për adresimin e çështjeve dhe problematikave të ngritura në këtë koncept dokument.

7.2. Opsioni i adresimit të një pjese të problemeve me akte nënligjore nuk parashihen të kenë kosto shtesë financiare, marrë parasysh se këto aktivitete mund të mbulohen me kapacitetet aktuale të institucionit që administron zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare dhe institucionet të cilat mbikqyrin zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare sipas ligjit aktual për ZSN.

7.3. Opsioni i rekomanduar nga Grupi Punues, pra hartimi i Projektligjit parashihet të mos ketë kosto shtesë financiare, marrë parasysh që ndryshimet kryesore që duhet të bëhen janë kryesisht të fokusuar në problemet e harmonizimit të Ligjit me standardet ndërkombëtare dhe

ato teknike, si dhe evitimit të problemeve në zbatimin e tij. Andaj, ndryshimet e propozuara në Ligjin për ZNS nuk janë subjekt i ndonjë implikimi financiar për buxhetin e Kosovës.

8. Konsultimet

8.1. Ky koncept dokument gjatë gjithë kohës është konsultuar me përfaqësuesit e institucioneve si Ministria e Punëve të Jashtme (Kryesues të Grupit Punues), Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike, Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose Konfiskuar, Banka Qendrore e Kosovës, Policia e Kosovës, Njësia për Inteligjencë Financiare dhe Dogana e Kosovës.

8.2. Grupi punues po ashtu që në fazat e hershme të hartimit të këtij koncept dokument është përkrahur nga ekspertët ndërkombëtar të projektit PECK "Projekti kundër Krimit Ekonomik" të financuara nga Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian të cilët kanë marrë pjesë në punimet e grupit punues për hartimin e koncept dokumentit për përafrimin e kornizës ligjore vendore për sanksionet ndërkombtare me qëllim të harmonizimit me standardet ndërkombtare.

8.3. Koncept dokumenti është konsultuar edhe me akterët dhe palët e tjera sipas Rregullores (QRK) Nr.05/2016 për Standardet Minimale për procesin e konsultimit publik, si dhe me Sekretariatit Koordinues të Qeverisë janë mbajtur konsultime për të adresuar kërkesat e Rregullores së punës së Qeverisë dhe Udhëzuesit për Hartimin e Koncept Dokumentit.

9. Pasoja e të gjitha opsioneve të konsideruara

9.1. Ndryshimi i Ligjit për ZNS nëpërmjet një Projektligji konsiderohet të jetë opsioni më i mirë dhe i rekomanduar për Qeverinë e Republikës së Kosovës. Më anë të këtij ndryshimi, synohet të adresohen të gjitha nevojat për realizimin e qëllimit të përcaktuar në këtë koncept dokument. Ndryshimet që synohet të adresohen në kuadër të opsionit të rekomanduar parashihen të lehtësojnë dhe të ngritin efektivitetin e zbatimit të Ligjit, e që synohet të shoqërohet me zvogëlimin e shpenzimeve për zbatimin e legjislacionit. Konkretisht, pasojat që priten të prodhojë ky opsion janë zbatimi më i lehtë i legjislacionit, sqarimi i procedurave dhe kompetencave dhe reduktimi i proceseve të mundshme gjyqësore.

9.2. Në anën tjetër, adresimi i qëllimit me akte nën-ligjore dhe me ndryshimin e qasjes duke ruajtur "status quon" nuk do të ishte zgjidhje e mjaftueshme për të adresuar mangësitë dhe për të përmbushur obligimet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës në luftën kundër terrorizmit. Dispozita të caktuara kanë të bëjnë edhe me të drejtat e njeriut të cilat sipas parimit të ligjshmërisë, nuk mund të rregullohen me legjislacionin sekondar, e assesi me ndryshim të qasjes në zbatim. Këto opsione mund të ofrojnë vetëm adresim të pjesshëm dhe të përkohshëm të qëllimit.

10. Rekomandimi

10.1. Opsioni i vetëm i grupit punues dhe opsioni i rekomanduar për Qeverinë e Republikës së Kosovës është opsioni i hartimit të Projektligjit të ri për plotësimin dhe ndryshimin të Ligjit ekzistues për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombtare të cilin proces do ta koordinoj MPJ dhe i cili ligj nuk do të ketë kosto shtesë financiare.

10.2. Andaj, MPJ planifikon që të përgatis draft ligjin për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombtare duke u bazuar në këtë koncept dokument dhe ta prezentoj për aprovim në Qeveri deri në fund të vitit 2017.

11. Mënyra e komunikimit të politikës së re publikut

11.1. Në kuadër të hartimit të Projektligjit, pra në kuadër të konsultimeve paraprake dhe publike, politika e re do të komunikohet për akterët e përfshirë në këtë konsultim. Po ashtu, debatet dhe tryezat që do të zhvillohen do të shfrytëzohen për komunikimin e politikës së re për publikun.

11.2. Pas miratimit të Projektligjit në Kuvendin e Republikës së Kosovës, parimisht, MPJ dhe subjektet tjera të ngarkuara me Projektligj do të kujdesen për komunikimin e politikës së re me publikun, qoftë nëpërmjet njoftimeve formale dhe takimeve për entitetet të caktuara, qoftë nëpërmjet kampanjave të ndryshme për njoftimin e publikut të gjerë.